

## **Ambassador SANDËR KOVAÇI**

U lind në **Mirditë**, më **18 tetor 1970**.

- Pasi mbaron shkollën e mesme të përgjithshme në **Gjinnazin e Rrëshenit** (1989), me rezultate të shkëlqyera, diplomohet me rezultate të larta për **Matematikë Speciale** (sistemi 5-vjecar, më **1994**), në **Fakultetin e Shkencave të Natyrës** të UT, si dhe për **Juridik** në **Fakultetin e Drejtësisë** të UT (2001). Merr titullin **Master i Shkencave** nga **Universiteti i Triestes, Itali** (2004), si dhe **laurohet në Matematikë** në po këtë universitet (2004). Merr titullin "**Doktor i Shkencave Matematike**" nga Universiteti Politeknik i Tiranës, duke mbrojtur disertacionin me temë: "*Modelimi i të dhënave hapësinore ambientale me anë të rrjetave neurale artificiale dhe teknologjisë GIS*" (2010), dhe titullin akademik "**Profesor i Asociuar**" (2016).
- Ka kryer disa **specializime pasuniversitare**, si në **Imperial College London (Britani)**; në **Universitetin e Pizës (Itali)**; në **Institutin e Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Kuala Lumpur (Malajzi)**; në **Mynih (Gjermani)**, etj. Fitues i disa bursave nga Komisioni Evropian dhe qeveri evropiane. Gjithashtu ka bërë disa specializime me specialistë perëndimor në fushën e analizës së marrëdhënieve ndërkombëtare.
- Është **autor** dhe bashkautor i **27 artikujve shkencorë dhe referimeve ndërkombëtare**, botuar në revista shkencore me prestigj ndërkombëtar, si dhe i **9 librave shkollorë** e universitarë në fushën e matematikës.
- Ka punuar në **institucione të ndryshme akademike e shtetërore**, ku përmendim përvojën mbi **15-vjeçare** si **pedagog matematike** në fakultete të ndryshme të **Universitetit Politeknik të Tiranës**, ku dhe është aktualisht. Ai ka kontribuar si lektor i Analizës Matematike, Algjebër dhe Gjeometrisë Analitike, Informatikës, Matematikës Financiare dhe Legjislacionit në Ndërtim. Gjithashtu, është angazhuar si lektor i Matematikës në degën e Arkitekturës në Albanian University, si dhe Matematikës së Aplikuar dhe Statistikës në **Universitetin European të Tiranës**. Është profesor i lëndës "**Të Drejtat e Njeriut dhe Sektori i Sigurisë**" dhe "Siguria Ndërkombëtare" në **Kolegjin Për Studime Evropiane (ISPE)**, Prishtinë.
- Ka një **eksperiencë diplomatike** si referent në MPJ dhe si **Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Sllovenisë (2008 - 2013)**, si dhe **Drejtor i Departamentit të Analizës në Shërbimin Informativ të Shtetit (2013-2015)**.
- Ka kontribute të veçanta si drejtues në organizata të ndryshme ndërkombëtarë si: **Kryetar i Asamblesë së Qendrës Ndërkombëtare për Promovimin e Ndërmarrjeve (ICPE)** (2011-2014), dhe **Anëtar i Byrosë Ekzekutive të YES Europe (2002-2004)** me qendër në Holandë. Gjithashtu është bashkëthemelues dhe drejtues didaktik i **Qendrës së Trajnimeve të Avancuara (QTA)** në Tiranë.
- Njeh gjuhën Angleze dhe ka njohuri te gjuhës frënge e italiane.
- Zoti Kovaçi është i martuar me znj. Mira Kovaçi (Xhuti), dhe është baba i 3 fëmijëve, Sara, Kevina dhe Rubin.